



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
I SANKSIONEVE

Data: 14 Dhjetor 2021

Nr: 114

VENDIM
PËR KTHIMIN E AKTEVE PËR PLOTËSIM

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, në seancën e vlerësimit paraprak të datës 14.12.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvis ÇEFA	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Ilijan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Organizata “Qëndresa Qytetare”

OBJEKT: Vendosje sanksioni administrativ në lidhje me vendimin nr. 467, datë 11.11.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 123/1, 124/1, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17, 18, 34, 35, 36, 40, 41 dhe 45 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator.



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, në seancën e shqyrtimit paraprak të datës 14.12.2021 pasi dëgjoi parashtrimet e z. Elvis Çefa, i caktuar relator i çështjes pas shortit të hedhur në datën 13.12.2021 dhe pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në portalin e denoncimeve, është raportuar nga Organizata “Qëndresa Qytetare” denoncimi me nr. ID të gjeneruar nga sistemi 2368, datë 19.03.2021, ndaj kandidatit për deputet të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, z. Alqi Bllako dhe Bashkisë Tiranë për kryerjen e një aktiviteti elektorale në ambientet e bibliotekës “Moikom Zeqo”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 467, datë 11.11.2021 ka vendosur ndër të tjera Konstatimin e shkeljes nga ana e z. Florian Pullazi, Administrator i Njesisë Administrative nr. 2, Tiranë si edhe t’i kërkojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, vendosjen e sanksionit administrative. Në respektim të kriterëve të përcaktuara është regjistruar në regjistrin e kërkesave të KSHZ me nr. 01.

KAS konstaton se: vetëm paraqitja e vendimit nr. 467, datë 11.11.2021 e KSHZ e shoqëruar me një shkresë të Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ nuk i plotëson mjaftueshëm elementët formalë për përmbajtjen e kërkesës për sanksione dhe masa disiplinore, të parashikuar në nenin 35 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator, në mënyrë që të konsiderohet një “Kërkesë për të vënë në lëvizje KAS” në kuptim të nenit 34 të së njëjtës rregullore.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenin 21 dhe në pikën 3/c të nenit 129 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në nenet 34 dhe 35 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S I:

1. Kthimin e akteve Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për plotësim të elementeve të formës, të përcaktuara në nenin 35 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.



2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

U shpall sot me datë 14.12.2021.

Elvis **ÇEFA** - **Relator**

Elvin **LAKO** - **Anëtar**

Ilirjan **RUSMALI** - **Anëtar**

Koli **BELE** - **Anëtar**

Ledio **BRAHO** - **Anëtar**

